



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 08 prot.

Himarë, më 27.06. 2025

Lënda: Zbardhja e procesverbalit nga origjinali, e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Himarë, zhvilluar më datë 27.06.2025 , mbledhje e radhës për muajin qershor.

Sot më datë 27.06.2025 zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak , ora 10:30, mbledhje e hapur .

Marrin pjesë këshilltarët:

Afrovita Dhimojani, Silva Burbo, Fuat Mati, Artan Bala, Timoleo Gërdhuqi, Qirjako Mërkuri, Lenica Kocani, Aleks Llazari, Nertila Husi, Loreta Isufi, Mirka Gjiçali , Gjergji Iliadhi, Dhimitër Kapaj , Nikolin Laska, Elisabeta Lamaj, Thodhori Foto, Thëllëza Kokaveshi, . Miltiadh Prifti . Mungojnë: Artionil Shirokaj (pa arsye) Maks Vlasi (pa arsye) .

Plotësohet Kuorumi Këshillit. Mbledhjen e drejton kryetari këshillit.

Jeni dakort me rendin e ditës? Me leje kryetar: - znj.Afrovita Dhimojani, përpara se të fillojmë me pikat e rendit të ditës unë dhe grupi im opozitar propozojmë të ngrem një komision për procedurën e prokurimeve publike . Kryetari këshillit:- jo zonja këshilltare, ne sot kemi një rend dite dhe do të vazhdojmë me këto pika , e lëmë për te çështjet e ndryshme këtë. Sqaron Kryetari Bashkisë :- ne dokumentat ja kemi dorëzuar kontrollit të lart të shtetit këtu në bashki , pasi të mbarojnë ata mund t'ju çojmë edhe juve në dispozicion , caktoni afatin e komisionit. Nuk lejohet , mbasi të mbarojnë ata mund ta merrni ju procedurën .

Pika 1 .

Shqyrtimi i PBA 2026 – 2028 në Bashkinë Himarë

Z. Fuat Mati :- Me leje, kam kërkuar nga mbledhja e mëparshme të na çohen në dispozicion të gjitha zbatimet e vendimeve nga drejtoritë përkatëse , dhe në Borsh kemi shumë probleme me ndotjen e ajrit, mbytjen akustike, betonieret . Z. Qirjako Mërkuri :-ne si këshilltarë kemi ngritur një sërë problemesh për Borshin , si zgjerimi varrezave, si shtrim dhe restaurim rrugës , kanalizime , e të tjera , duam të dimë kur do të marrin zgjidhje? Sqaron sektori përgjegjës për prokurimet : në lidhje me ujitje- kullim ka ngel vetëm një segment në Haliq për t'u bërë dhe së shpejti do të zgjidhet , kapaciteti i firmës kaq është, dhe prokurimet janë bërë me vonesë pasi vonë janë miratuar.

Kryetari komisionit për financën dhe auditin relaton procesverbalin dhe raportin e komisionit. Si komision e shqyrtuam , në disa paqartësi na i shpjegoi drejtori përkatës , dhe vendosëm të kalojmë për shqyrtim në këshill dhe më gjerësisht e diskutojmë sëbashku.

Znj.Thëllëza Kokaveshi :- tabelat ishin bosh në pba, për vitin 2025 bosh , tabelat janë bosh tani sepse vlerat rishikohen në korrik , shtator dhe dhjetor, nuk kemi shënuar projektet, vlerat janë çuar , nuk kemi përcaktuar investimet kapitale dhe operative, zëri total është vendosur dhe kur bëjmë dëgjuesat publike , i cakton komuniteti projektet jo ne . Z. Timoleo Gërdhuqi :- keni bërë dëgjuesë publike për PBA-në ? Drejtori Laert Mezani :- nuk bëhen dëgjuesat tani për PBA. A mundet të çojmë në PBA qoftë edhe një rrugicë? A kemi të drejtë të bëjmë propozime ne tani? Drejtori : - jo nuk është momenti tani . Z. Dhimitër Kapaj :- sqaroje më mirë , qartë PBA- në këshillit.

Z. Timoleo Gërdhuqi :- pa kaluar PBA- në investohet gjë ?

Sqaron drejtori përgjegjës:- pa miratuar në këshill nuk kalon asgjë, është alokuar fondi buxhetor por jo produktet.

Znj. Silva Burbo :- Është detyrim ligjor ta miratojmë ne si këshill këtë, aty bëhet një plan duke u orientuar nga kërkesat e komunitetit , kjo PBA do të kalojë në prefekturë me tabela zero , a është ligjore kjo? Sqaron drejtori : - I kemi të parashikuara me zëra , i kemi alokuar fondet por jo t'i çojmë në dispozicion. Znj.Silva Burbo:- tabelat për 2023, 2024, 2025 janë zero. Kryetari këshillit :- tabelat janë zero , nëse është kështu si thonë këshilltarët , çfarë na vlen ne që mbledhemi këtu, çfarë serioziteti ka këshilli nëse na e kthen jo të ligjshme prefektura ? Znj.Afrovita Dhimojani :- Çfarë rekomandimi ju ka sjell ministria duhet të na i çoni në dispozicion , përsa i përket PBA- së thotë se është punë e bashkërenduar , logjike k bie të jenë të gjitha drejtorit por nga formulimi duket i paplotë.

Kryetari këshillit :- e hedhim në votim , sa janë pro, kundër, abstenim?

Z. Timoleo Gërdhuqi , si anëtarë këshilli do të shtojë dy zëra të venë në prefekturë, propozojë dy rrugë , një në fund të fshatit Qazim Pali, dhe e dyta “ rruga nacionale Borsh – Sarandë” rruga “ Dushkë” në lagjen Micajt. Sqaron drejtori projekteve, PBA kalohet çdo vit , të mos ngatërrojmë buxhetin me PBA , pba fillon me tavanet , është në fazë përgatitore që shikohen të ardhurat dhe prioritetet, shikojmë të ardhurat, mbledhim dhe buxhetin dhe jua sjellim në shtator, pba është me faza në dhjetor do të vijë dhe me shifra dhe me zëra . Kryetari këshillit :- e hedhim në votim ? Miratohet PBA me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro , katër (4) kundër , zero (0) abstenim (Silva Burbo, Miltiadh Prifti, Afrovita Dhimojani, Timoleo Gërdhuqi janë kundër)

PBA miratohet me nr.25 Vendim.

Pika 2

Shqyrtimi i projektvendimit “ Për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqeje prej 5 ha Shoqërisë Soleil dhe Sea Sh.P.K

Znj. Silva Burbo :- unë nuk jam dakort me këtë projektvendim, të japësh sipërfaqe toke duhet të rishikohen qartë gjërat , si dëgjesa publike, publikimi i projektit për publikun, marrjen e me mendimit nga kryesia e fshatrave, evidentimi i saktë i hartave e të tj. Kryetari Bashkisë :- çdo miratim do të firmoset me kontratë me rezervë , nëse na dalin konflikte do të pezullohet menjëherë kontrata. Z.Timoleo Gërdhuqi : ka tre llojë tip kontratash dhe nëse toka del me zot ndërpritet menjëherë kontrata nga Bashkia.

Kryetari këshillit :- e hedhim në votim, sa janë pro, kundër, abstenim?

Miratohet Pika 2 e rendit të ditës me nr. 26 vendimi “ Për miratimin në parim për dhënien e fondit pyjor kullosor shoqërisë Soleil dhe Sea , sip prej 5 ha. Ky projektvendim u zëvendësua me të njëjtin projektvendim që është në rendin e ditës por me ndryshim sipërfaqeje , nga 1 ha u miratua me 5 ha, vendim i marr nga komisioni i bujqësisë , pyjeve, kullotave dhe aseteve të bashkisë të cilën e relatoi kryetari komisionit z.Milto Nika.

Pika 3

Shqyrtimi për dhënien në përdorim fondin pyjor kullosor “ Mali Pilurit Çikë “ z. Bardhosh Çeloleskaj sip prej 1.74 ha

Z. Timoleo Gërdhuqi :- zotërinë duhet ta stimulojmë sepse kërkon tokë për akroturizëm dhe këtë e njehë ligji , pse mos ta marr , jemi pro agroturizmit .

Znj. Thëllëza Kokaveshi :- A ka bërë ndonjë studim bashkia për këtë , jo se jam kundër për këtë , por ky investim kërkohet afatgjatë , komuniteti a është në djeni për këtë , është bërë njoftim, afishim , dëgjese ? Sqaron drejtori juridik :- Nuk ka tjetërsim prone , ky është hapi parë që ndjek bashkia. Kjo është kërkesë në parim, pastaj bëhet lidhja e kontratës e cila miratohet nga ju. Jeni në fazën e parë , mbas miratimit tuaj në parim ne vijojmë me procedurat ligjore me radhë .Znj.Afrovita Dhimojani :- dhënia në parim do të thotë se ky akt pasi kalon në këshill nuk merr formën e vendimit apo si ? Drejtori juridik: - I gjithë procesi hap mbas hapi kalon në Këshillin bashkiak.Ne pretendojmë që nuk është e drejtë, ju vjen një kërkesë , bashkia të ngrer komisionin nga ASHK , të ngrer grupin e punë për të parë koordinatat dhe për të ndjekur procedurën , ju përgjegjësinë ligjore e shkarkoni në këshill ? z. Kryetar e kam me juve,pse nuk bëni verifikimet e duhura, ju miratoni në parim një kërkesë e cila nuk është e bazuar . Kryetari Bashkisë:- ne i jemi drejtuar ASHK dhe ka një plan rivelimi nga ASHK me kordinata, mbasi na jepni të drejtën për ta miratuar kontratën , gjithë stafi përkatës do të merret me procedurën mbasi na e jepni ju të drejtën për ta filluar. Znj.Silva Burbo :- kryetar materiali nuk është i plotë. Kryetari Bashkisë :- nëse është kështu ,të mos e miratoni ! Kryetari Këshillit:- e hedhim në votim , sa janë pro, kundër , abstenim? Miratohet me shtatëmbëdhjetë vota pro (17) , një (1) kundër (Silva Burbo) , një (1) abstenim (Afrovita Dhimojani) vendimi me nr.27

“ Për dñiem në parim për dhënien e fondit pyjor kullosor sip prej 1.74 ha në ekonominë pyjore kullosore “ Mali i Pilurit , Çikë” , ngastra 69, ZK: 3813 në favor të z. Bardhosh Çeloleskaj.

Pika 4

Për dhënien në parim nga fondi pyjor kullosor në favor të shoqërisë “ Dulla Konstruktion” sip prej 2.9 ha , 3 ha, sepse është lapsus te projekti i sjell. Sqaron drejtoria juridike :- do të kryhet i gjithë studimi. Z. Fuat Mati:- ne e kemi 20 ha këtu, projekti nuk është kështu këtu ? Z. Timoleo Gërdhuqi e miratojmë dhe në zbardhje e rregullojmë nga 2.9 ha e bëjmë 3 ha. Kryetari këshillit :- e hedhim në miratim me 3 ha Shoqërinë “ Dulla Konstruktion”? Sa janë pro , kundër , abstenim?

Miratohet me pesëmbëdhjetë (15) vota pro , katër (4) kundër , zero (0) abstenim , vendimi nr.28 “ Për dhënien në parim fondi pyjor kullosor sip prej 3 ha shoqërisë “Dulla Konstruktion” në Palasë , zk: 2863. (Silva Burbo , Miltidh Prifti , Aleks Llazari, Thëllëza Kokaveshi kundër) Këshilltarja Silva Burbo largohet nga mbledhja pasi qytetari i thotë që unë të kam votuar të përfaqësosh mua këtu , po largohem edhe unë, ndërkohë rikthehet sërish në mbledhje.

Pika 5

Shqyrtimi për transferimin në pronësi të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës – Kanalizimeve Vlorë , ujësjellësi Bolenë, ujësjellësi Kallarat dhe ujësjellësi Kuç, impiant i trajtimit të ujërave të ndotura. Relaton kryetari komisionit z. Milto Nika. Kryetari këshillit kërkon të relatoi kush e ka përpiluar materialin. Znj. Afrovita Djimojani :- Pika 5 dhe pika 6 z. Kryetar keni dijeni për këtë procedurë ? Kryetari Bashkisë:- zonja këshilltare kur është bërë kjo marrëveshje keni qënë në këshill ? Kryetari Bashkisë :- ujësjellësit janë pjesë e aseteve të bashkisë dhe kjo kërkesë I referohet këshillit për transferim sepse në këto kushte që jemi si psh Kuçi pa ujë sepse është përfunduar dhe nuk është në përdorim dhe më duket t’ja kalojë Sh. A .Vlorë , pasi këshilli I mëparshëm këtë aset të Bashkisë e ka kaluar në Sh.A. Vlorë. Këshilltarja Afrovita Dhimojani dhe kryetari Bashkisë replikojnë për këtë temë .

Këshilltarja Thëllëza Kokaveshi dhe Mirka Gjiçali replikojnë me njëra – tjetrën dhe z.Thëllëza Kokaveshi largohet e revoltuar nga mbledhja. Kryetari këshillit:- ta hedhim në votim? Znj. Afrovita Dhimojani :- Në vitin 2022 këshilli i mëparshëm e ka miratuar në parim këtë marrëveshje për dhënien e aseteve ujësjellës SH A Vlorë, në vitin 2023 na ka ardhë përsëri kërkesë për këtë marrëveshje ku kam qënë edhe unë këshilltare edhe e kemi kundërshtuar dhe kemi miratuar tre vendime kundër për të nisur hetimet rreth kësaj çështje . Unë jam kundër për këtë vendim , mund të ma shpjegoni pse këto asete kanë ngel jashtë kësaj marrëveshje? Kryetari Bashkisë:- Këshilli Bashkiak u ka dhënë të drejtën kryetarit të mëparshëm për këtë miratim dhe nuk e di pse këto fshatra kanë ngel jashtë .z.Timoleo Gërdhuqi :- kam kërkuar që sekretarja të lajmëroj administratorët e njësisë dhe kryetarët e fshatrave të jenë prezent e të flasim për këtë temë , të japin ata mendimin e tyre pastaj vendosim ne . Sqaron drejtori : - kur është bërë kjo

marrëveshje këto fshatra që janë ngel jashtë kanë qënë në projekte, në punime , tani që i kemi marrë në dorëzim do t'i bashkojmë me SH.A. Vlorë .Sqaron Kryetari Bashkisë:- ujësjellësi ka kaluar , e keni kaluar ju , sot Kuçi nuk ka ujë, po kujt t'i drejtohem unë për këtë, ne si bashki nuk kemi më kompetenca. Si të kalojmë fonde ne për këto fshatra kur nuk kemi ujësjellës?! Kërkon fjalën kryetari I fshatit Kuç – Qëndër z. Astrit Balilaj :- Ju përshëndes të gjithëve dhe ju falenderoj për diskutimin, ujësjellës i Kuçit ka përfunduar është marr dhe në dorëzim por nuk ka ujë nëpër shtëpi, na u premtua ujë 24 orë, ne duam të jenë funksional. E zgjidhni si të doni , ne duam të na vijë ujë .znj. Afroviata Dhimojani : - zona juaj ka mbështetet këtë qeveri dhe kryetari t'ua miratojë ku u marrin ujin, lumin sepse e keni mbështet. Z. Fuat Mati :- të vendoset si është më e mira për komunitetin . Znj. Elisabeta Lamaj :- pse duhet ta dorëzojmë , kur nuk keni ujë në Kuç, të hetohet cila firmë e mori përsipër , ku shkuan kaq lekë , kush e miri në dorëzim ? Administratori njësisë Horë – Vranisht :- në këtë situatë që jemi sot asetet e ujësjellës janë në Vlorë dhe ne shërbimet i marrim andej. Ujësjellësin Kuç e ka bërë fondi shqiptar i zhvillimit dhe në shpërndarje nuk funksionon . Kryetari këshillit :- sa janë pro, kundër, abstenim ?

Miratohet vendimi nr. 29 me katërmëdhjetë (14) vota pro, 4 kundër (Afroviata, Miltiadh, Aleks, Silva) zero (0) abstenim , vendimi mbi transferimin në pronësi të aseteve ujësjellës Kuç, Kallarat, Bolenë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës – Kanalizimeve SH.A Vlorë.

Pika 6.

Mbi transferimin kapital të aseteve me objekt përmirësimin e ujit të pijshëm Dhërmi, Gjilekë, Kondraq dhe Palasë ujësjellës – kanalizime Sh.A Vlorë.

Miratohet me pesëmbëdhjetë (15) vota pro, dy (2) kundër (Afroviata, Miltiadh) , zero (0) abstenim

Miratohet me nr.30 vendimi .

Pika 7

Miratohet me pesëmbëdhjetë(15) vota pro, dy (2) kundër (Afroviata, Miltiadh) , zero (0) abstenim , vendimi me nr.31 “ Për dhënien me qëra të një ambienti për t'u përdorur si magazinë për NSHP.

Pika 8

Miratohet ndihma ekonomike me nr. 32 vendimi “ Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1 – 31 maj nga fondi i kushtëzuar 6% I bllok- ndihmës me shtatëmbëdhjetë (17) vota pro, zero kundër, zero abstenim.

Të ndryshme

Kryetari këshillit lexon kërkesën e një qytetari ku kërkon që babai i tij të ndërtohet “ Qytetar Nderi” i bashkisë Himarë , bëhet fjalë për të ndjerin Novruz Fikaj Kuç. Këshilli shprehet se nuk kemi ngritur ende komision për këta tituj. Në mbledhjen e ardhshme duhet të sjellim një

projekt për ngritjen e këtij komisioni. Kryetari Bashkisë:- ju lutem më dëgjoni kam një kërkesë
“ T’i kërkojmë ministres Kumbaro reduktimin, uljen e zhurmave në Himarë , jemi dakort ?
Këshilli:- po.

Miratohet vendimi nr.33 “ Himara të Miratohet pa zhurma” me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro,
zero (0) kundër , zero (abstenim)

Kjo kërkesë u propozua nga Kryetari Bashkisë ku u hodh në votim dhe u miratua.

Kryetari këshillit mbyll mbledhjen pasi firmosi protokollin e mbajtur gjatë mbledhjes.

Sekretari
Elena Memushaj

